



LEZHË

“Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse”.

Shoqata “Gruaja Vizioni i Ndryshimit” në Lezhë, aplikoi dhe implementoi iniciativën “Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse”. Kjo iniciativë kishte si qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit dhe organeve vendimmarrëse për një qeverisje demokratike dhe gjithëpërfshirëse në komunat Kallmet dhe Kolsh. Aktivitetet e realizuara u fokusuan kryesisht në fushën e informimit mbi funksionimin e vendimmarrjes nga Këshilli i Komunës, mbështetja dhe inicimi i një bash-

këpunimi mes komunitetit femëror si pjesa më e marginalizuar dhe më pak e përfshirë në hartimin e vendimmarrjes komunitare. Për të arritur një pjesëmarrje të mirë të grave, janë realizuar disa takime individuale dhe në grupe të vogla me gratë e fshatrave të dy komunave të përzgjedhura. Më pas janë organizuar dy trajnime në grup, një me gratë ku përveç informimit mbi çështjet gjinore është bërë edhe hartimi i disa propozimeve që kërkojnë ndërhyrjen e institucionit të Komunës. Tra-



jnimi i dytë i përbashkët mes grave dhe përfaqësuesve të keshillit të komunës, u përqendrua mbi zbatueshmërinë e këtyre propozimeve.

BERAT

Shoqata “Jetimët në Fokus” forcon strukturat e saj

Nisma mbi ngritjen e strukturave të shoqatës si dhe rritja e kapaciteteve drejtuese të tyre në Bashki dhe Komunitet e qarkut Berat e ndërmarrë nga shoqata “Jetimët në fokus” ishte rrjedhojë e nevojës për të mbështetur këtë kategori sociale të marginalizuar. Në përfundim të nismës u arrit ngritja e dy degëve të tjera të shoqatës në

Polican dhe Çorovodë. Kjo ishte rezultat i një procesi të gjatë takimesh dhe konsultimesh me aktorët e qeverisjes lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset që mund të kontribuojnë në pajisjen e ambienteve të reja. Krahas kësaj, gjatë nismës iu kushtua një vëmendje të veçantë disa aspekteve të tjera që

lidhen drejtpërdrejt me rritjen e kapaciteteve të personave të përfshirë në strukturat e shoqatës. Kështu u organizuan disa seminare në lidhje me bazën ligjore të OJF-ve, të drejtat e fëmijëve jetimë, legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi, aspektet financiare dhe aftësimi për ngritje fondesh.



Nisma “Skrapari, i Pastër dhe i Shëndetshëm” kishte si qëllim të përgjithshëm ndërgjegjësimin e komunitetit për pjesëmarrjen qytetare në mirëqeverisje

SKRAPAR

Nisma “Skrapari, i Pastër dhe i Shëndetshëm”

dhe promovimin e vullnetarizmit. Konkretisht kjo nismë u shtri në bashkinë e Çorovodës duke adresuar çështjet e menaxhimit të mbetjeve në nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare dhe nxitjes së vullnetarizmit. Aktivitetet përfshijnë realizimin e tri trajnimeve për menaxhimin e mbetjeve me 10 nëpunës lokalë të Bashkisë së Çorovodës, Agjensisë Rajonale të Mjedisit Berat, si dhe sesione informimi për 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim)

dhe aksione pastrimi në disa shkolla 9-vjeçare. Një nga produktet e kësaj nisme ishte dhe përpilimi i një raporti në formën e një direktive “Menaxhimi i mbetjeve urbane në qytetin e Çorovodës” me prioritete dhe rekomandime për Bashkinë Çorovodës. Ky dokument u konsultua me përfaqësuesit lokalë dhe aktorë të tjerë të interesuar dhe gjeti mbështetje prej tyre.



SKRAPAR

“Romët e Veriut” - Përmirësim të politikave për mbështetjen e komunitetit

Duke pasur parasysh nevojën për të ndërhyrë në lidhje me problematikat me të cilat përballen Romët, shoqata “Romët e Veriut” zbatoi aktivitetet e saj në komunat e qarkut Lezhë me përqendrimin më të madh të këtij minoriteti. Gjatë aktiviteteve të kësaj nisme u hartua një buletin ku përfshihej e gjithë problematika e evidentuar gjatë takimeve dhe intervistave

të realizuara nga anëtarët e kësaj shoqate. Ky buletin u shpërnda tek strukturat dhe institucionet e qeverisjes vendore në qarkun e Lezhës, me qëllim përmirësimin e politikave për mbështetjen e komunitetit Rom. Disa nga çështjet që u trajtuan dhe u ngritën nga pjesëmarrësit në takime ishin arsimi, punësimi, strehimi dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor.



LEZHË

Nisma “Edhe Ne Jemi Pjesë e Komunitetit Qytetar”

Shoqata “Shpresë për të Varfrit” e përqendroi nismën “Edhe Ne jemi pjesë e Komunitetit Qytetar” në zonat periferike të qytetit të Lezhës. Përfutuesit kryesorë të kësaj iniciative ishin fëmijët dhe

të rinjtë e komunitetit Egjiptian të zonës. Nisma kishte për qëllim pranimin dhe njohjen e të rinjve të Komunitetit Egjiptian si një hallkë kyçe, dhe e qëndrueshme për zhvillim, lobim dhe advokaci. Gjithashtu rritja e përfaqësimit dhe integritit të tyre në shoqëri ishte ndër shqetësimet kryesore të nismës. Kjo iniciativë filloi me një fushatë sensibilizuese dhe me vetë prezantimin e projektit në zonën periferike ku u operua dhe zbatuan aktivitetet. Gjatë

hapit të parë u publikuan fletëpalosje me informacion të përgjithshëm mbi nismën si dhe u përgatitën posterat me qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve të komunitetit egjiptian dhe komunitetit në tërësi. Në vazhdim u ndërmorën një cikël takimesh me të për të diskutuar mbi çështje që përbëjnë interes për këtë grup për të drejtat e njeriut, SST trajtimi dhe parandalimi i tyre, arsimimi, punësimi dhe integrimi i tyre në shoqëri.

LEZHË

Nxitja e Politikave dhe Praktikave të Mira në Vendimmarrjen Lokale Midis të Rinjve

“Komiteti Rinor” - Lezhë, përfshiu në nismën e saj, të rinjtë e 8 komunave të qarkut Lezhë. Nisma kishte për qëllim nxitjen e politikave dhe praktikave të mira në vendimmarrjen lokale midis të rinjve. Krahas shtrirjes së gjerë në këtë rajon iu kushtua një rëndësi e veçantë dhe përmbajtjes së takimeve me të rinjtë. Gjatë tri mua-

jve të zbatimit të nismës u organizuan takime të ndryshme ku u diskutuan tema si: pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje, rritja e aftësive drejtuese të të rinjve në komunat përkatëse, etj. Takimet u zhvilluan pranë ambienteve të komunave, ku morën pjesë dhe përfaqësuesit e komunave, nëpër shkolla dhe në zyrat e organizatës.



ELBASAN

Nisma për Krijimin e Rrjetit të Fermerëve

Në nismën që zbatoi Projekti Ndërkombëtar i Mëshqerrave (PNM) u mundësua ngritja e një Rrjeti të shoqatave të fermerëve të komunave Karinë, Për-

parim, Sinaballaj, Gjocaj dhe Pajovë në Qarkun e Elbasanit. Ky rrjet do të mundësojë rritjen e kapaciteteve dhe aftësitë lobuese të fermerëve për zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit të vogël rural/familjar dhe përmirësimin e mjedisit të zonave respektive. Gjatë implementimit të nismës u krijuan premiset për përmirësimin e bashkëpunimit të rrjetit të shoqatave lokale

të fermerëve me strukturat e pushtetit lokal dhe biznesin në përgjithësi. Kjo u arrit nëpërmjet një serie seminaresh me qëllim rritjen e kapaciteteve të rrjetit të fermerëve. Rreth 160 fermerë morën pjesë në takimet dhe aktivitetet e tjera të realizuara në kuadër të kësaj nisme. Gjithashtu u realizua një fushatë ndërgjegjësuere për pastrimin dhe mbajtjen pastër të mjedisit.

ELBASAN

Ndërgjegjësimi i të Rinjve në Lidhje me Problemet më të Mprehta


Shoqata “Në dobi të gruas shqiptare” implementoi nismën me fokus ndërgjegjësimin e të rinjve në lidhje me problemet e mprehta me të cilat ato ballafaqohen. Në këtë kuadër u realizua një seri seminaresh me të rinjtë e qarkut Elbasan mbi tema si: mbrojtja e të drejtave të njeriut, barazia gjinore, duhani dhe efektet negative të tij, sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST), dhuna në familje, mbrojtja e mjedisit dhe nx-

itja e vullnetarizmit. Në përfundim të ciklit të seminareve u realizua një aktivitet kulturor me të gjithë të rinjtë që morën pjesë në nismën “Të rinjtë janë aktorë, partnerë edhe prijësit kryesorë të transformimit shoqëror të një vendi në zhvillim”. Një hap tjetër të rëndësishëm që u ndërmor gjatë nismës ishte krijimi i organizatës rinore pranë komunës ku u zbatuan aktivitetet e parashikuara. Kjo do të shërbejë në aktivizimin dhe organiz-





ECSRA : MONITORIMI E VLERËSIMI



Në kuadër të projektit “Fuqizimi i Kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike” (ECSRA) u realizua dhe vlerësimi dhe monitorimi i këtij projekti duke evidentuar një listë çështjesh, sfidash, praktikash të mira dhe mundësive që kanë karakterizuar implementimin e nismave të këtij projekti. Kjo iniciativë e PNUD u implementua në mënyrë eficiente në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim i cili ishte edhe drejtuesi i këtij projekti,

me politika e strategji të mbështetura nga strukturat e qeverisjes vendore. Inkurajimi i bashkëpunimit dhe nxitja e debatit të informuar midis aktorëve të ndryshëm lokalë të përfshirë në zhvillimin rural, është një element mjaft i rëndësishëm i kësaj nisme. Prandaj është e nevojshme mbështetja e përpjekjeve të ngjashme mbi zhvillimin e kapaciteteve e zonave rurale në këto fusha:

- Përgatitja e strategjive të zhvillimit.

- Ndërtimi dhe implementimi i platformave operuese të inovacionit rural
- Krijimi dhe forcimi i Grupeve të Veprimit Lokal
- Implementimin e strategjive lokale të zhvillimit
- Promovimin dhe bashkëpunimin mes zonave rurale dhe urbane në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar.

Gjatë implementimit të projektit fokusi u vendos tek aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra nga organizatat locale duke marrë në konsideratë aftësitë dhe kapacitetet e tyre, dhe duke realizuar ngritjen e këtyre kapaciteteve sipas nevojave. Kjo edhe në varësi të kontekstit dhe dinamikës së rajoneve të targetuara. Bazuar në kapacitetin e kufizuar lokal për të krijuar Grupet e Veprimit Lokal, si dhe në kapacitetet e pamjaftueshme për të zhvilluar strategji të zhvillimit rural, mund të theksohet se në të ardhmen nevojitet më shumë mbështetje për rritjen e kapaciteteve locale dhe një rol më aktiv të organizatave vendore.

PNUD nis konsultimet me të rinjtë në mbarë vendin

PNUD – Shqipëri nisi takimet konsultative në të gjithë vendin për të siguruar opinionet dhe kënvështrimet e qytetarëve në të gjithë Shqipërinë mbi nevojat dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen, fëmijëve, komunitetin ku jetojnë dhe vendin në tërësi. Qëllimi i këtyre konsultimeve me të rinj nga mbarë vendi është marrja pespektivave të tyre mbi çështje kyçe si punësimi, mjedisi, edukimi etj. Konsultimet përfshijnë një përmbledhje të sfidave që të rinjtë përballen sot

në tregun e punës, punësimi informal etj. Konsultimet e para nisën në qytetin e Librazhdit në partneritet me organizatën Eorl Vision. Të rinj të moshave 16-20 vjeç morën pjesë në diskutimin mbi punësimin ku u fol mbi sfidat që ata përballen cdo ditë, mungesën e investimeve në zonë dhe apatisë që është përhapur tek gjenerata e re. Konsultimet dnga këto takime do të shërbejnë në përgatitjen e “Agjendës së Zhvillimit Global Post-2015”. Diskutimet gjithashtu do të kontribuojnë në strategjinë e re të punësimit, në veçanti përsa i përket komponentit të punësimit të të rinjve. Në vitin 2000, të gjitha vendet u zotuan për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, që kanë si qëllim reduktimin e varfërisë ekstreme, ndalimin e përhapjes së HIV AIDS-it nëpërmjet edukimit – deri në vitin 2015. Disa vende kanë arritur

objektivat, ndërsa disa të tjerë mbeten mbrapa. Cilat do të jenë objektivat pas vitit 2015? Në këtë kuadër Kombet e Bashkuara kanë nisur një proces të gjerë konsultimesh në shtete të ndryshme të botës për të përgatitur prioritetet e zhvillimit pas vitit 2015. Shqipëria është një prej vendeve ku këto konsultime po kryhen me qëllim përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në këtë proces dhe advokimin për zhvillimin e një procesi të informuar të përgatitjes së prioritetëve post 2015.

KONFERENCA
KOMBËTAREPartnerë për Ndryshim në Zonat Periferike;
Fuqizimi i Qytetarëve për Zhvillim me Pjesëmarrje

Në përfundim të projektit “Fuqizimi i Kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike”, IDM në bashkëpunim me zyrën e PNUD-it në Shqipëri, organizoi në ambjentet e “Hotel Tirana International”, Konferencën Kombëtare: Partnerë për ndryshim në zonat periferike; fuqizimi i qytetarëve për zhvillim me pjesëmarrje. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë të qeverisë si Ministri i Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, z. Genc Ruli, deputetë, Z. Francois Begeot nga Delegacioni i BE-së, përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, përfaqësues të organizatave



ndërkombëtare si drejtoresha e PNUD – Shqipëri znj. Yesim Oruc, drejtues të organizatave të shoqërisë civile me fokus në zonat rurale e periferike, ekspertë të zhvillimit rural, donatorë etj. Gjatë fjalës përshëndetëse Drejtori i IDM-së, z. Sotirag Hroni falenderoi të gjithë aktorët që kontribuan dhe mbështetën programin “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike” me shtrirje në rrethet Gjirokastrë, Elbasan, Berat dhe Lezhë. Ministri Ruli gjatë fjalës së tij theksoi rëndësinë që ka shoqëria civile në zhvillimin e zonave rurale duke veçuar edhe përpjekjet e qeverisë në finacimin e zhvillimit bujqësor dhe fermerëve me skema financimi shumë efikase. Drejtoresha e PNUD-Shqipëri znj. Yesim Oruc theksoi se ky program vjen si përgjigje ndaj nevojave të komuniteteve rurale në një kohë që PNUD në objektivat e saj kryesore trajton si prioritare forcimin e shoqërisë civile në zonat rurale e periferike.

Kordinatorja e projektit ECSRA-s Znj. Elona Dhëmbo realizoi një panoramë të shkurtër të fazave dhe shtrirjes së projektit, duke u përqëndruar në produktet dhe rezultatet e tij. Konferenca vazhdoi me dy panelet e organizuara, ku ekspertët e IDM-së realizuan prezantimin e dy dokumenteve politikë: “Ku po gabojnë donatorët, shteti dhe shoqëria civile” dhe dokumenti politik “Zhvillimi rural me pjesëmarrje në Shqipëri: Gjendja aktuale dhe sfidat e ardhshme”. Në vijim, të ftuarit u përqëndruan kryesisht në eksperiencat e sjella gjatë implementimit të programit ECSRA-s gjatë 18 muajve të fundit.



“Libri i Arritjeve” synon të refletojë punën, arritjet, pengesat dhe sfidat e hasura gjatë implementimit të projektit 2 vjeçar. Konceptuar si një broshurë informuese ku përfshihen të gjitha statet e këtij projekti duke nisur nga dizenjimi i strategjisë së punës, deri tek implementimi i iniciativave nga aktorët lokalë botimi do të shërbejë si një dokument bazë për t’u referuar në iniciativat e tjera që do të ndërmerren në të ardhmen në kuadër të projekteve që mbështesin dhe nxisin forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve të sho-



qërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Në një kohë që “Revista Komunitare” shoqëroi në mënyrë periodike zhvillimin dhe implementimin e projektit, broshura “Libri i Arritjeve” bën një përmbledhje të aspekteve më të rëndësishme të projektit. Përveç informacionit mbi qëllimin dhe arritjet e projektit, broshura i jep një rëndësi të veçantë kontekstit lokal në të cilin ky projekt u zhvillua, duke realizuar një përshkrim të detajuar të rajoneve ku u iniciativat e këtij projekti u shtri-